



Ky projekt financohet  
nga Bashkimi European



**PARTNERËT SHQIPËRI**  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM



**QENDRA KOMBËTARE BURIMORE**  
PËR **SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI**

# VLERËSIMI I KAPACITETEVE DHE NEVOJAVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË SHQIPËRI

## Raport Vlerësimi



# VLERËSIMI I KAPACITETEVE DHE NEVOJAVE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NË SHQIPËRI

© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.  
Tiranë, Shqipëri 2023

## Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Email: [partners@partnersalbania.org](mailto:partners@partnersalbania.org)

Website: [www.partnersalbania.org](http://www.partnersalbania.org)

## Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile

Email: [info@resourcecentre.al](mailto:info@resourcecentre.al)

Website: [www.resourcecentre.al](http://www.resourcecentre.al)

Rruga e Elbasanit, Godina Park Gate, Kati I 10-të,

Ap. 71 / 73, PO BOX 2418/1

Kodi Postar 1010, Tirana, Albania

Tel: +355 4 2254881

## Përgatitur nga:

Xhoana Zeqo

## Grafika dhe faqosja:

Regana Hysenbelli

Ky raport është realizuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Informacioni dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë ato të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian. As institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian, as cilindo person që vepron në emër të tyre, nuk mund të konsiderohet përgjegjës për përdorimin që mund të bëhet nga informacioni që përmban ai.

Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Shqipëri falenderon të gjitha organizatat për bashkëpunimin dhe përfshirjen në realizimin e këtij studimi.

## HYRJE

Ky vlerësim u realizua nga Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, një platformë për shoqërinë civile në nivel kombëtar e lokal, në mbështetje të fuqizimit të kapaciteteve të sektorit, nxitjes dhe lehtësimit të dialogut në politikëbërje dhe përpjekjeve advokuese për një mjedis mundësues.

Qendra është një nismë e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, e nisur në vitin 2019, e cila zbatohet në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Evropiane në Shqipëri (EMA), me mbështetjen e Bashkimit Evropian.

Vlerësimi synon të identifikojë nevojat aktuale të organizatave për rritje kapacitetesh në fushën e manaxhimit organizativ, qendrueshmërisë financiare, pjesëmarrjes në politikëbërje dhe procesit të integritimit Evropian. Nevojat e identifikuara do të shërbejnë si bazë për zhvillimin e programeve të ardhshme për rritje kapaciteti nga Qendra Kombëtare Burimore në shërbim të sektorit të shoqërisë civile. Gjetjet e vlerësimit gjithashtu mund t'u vijnë në ndihmë organizatave, donatorëve dhe institucioneve të tjera që punojnë për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit në vend.

Për hartimin e këtij raporti, Qendra Kombëtare Burimore ndërmorri një vëzhgim online nëpërmjet një pyetësoi gjysmë të strukturuar, shpërndarë dhe plotësuar nga organizata të shoqërisë civile (OSHC) përgjatë muajit mars-prill 2023. I organizuar në 4 seksione kryesore, pyetësoi synonte identifikimin e nevojave për trajnim dhe asistencë mbi aspekte kyçe zhvillimore të organizatave të shoqërisë civile dhe veprimtarisë së tyre si: (1) qeverisjen organizative, zhvillimin dhe manaxhimin organizativ (2) pjesëmarrjen në politikëbërje dhe përfshirjen e organizatave në nisma advokuese (3) pjesëmarrjen e organizatave në proceset e integritimit evropian si dhe (4) bashkëpunimin OSHC-Media. 115 organizata nga të dymbëdhjetë qarqet e vendit, morën pjesë në këtë vëzhgim duke plotësuar pyetësoin online dhe shprehur opinionet e tyre.

### Kufizimet e vlerësimit

Gjatë zhvillimit të raportit, si në mbledhjen e të dhënave dhe në shkrimin e raportit të vlerësimit kufizimet kryesore ishin: (1) numri i organizatave të përfshira, i cili megjithëse në dukje është i ulët në krahasim me numrin e organizatave që rezultojnë të regjistruara (2000+ OSHC të regjistruara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve), është një kampion studimi përfaqësues sepse përfshin pjesën më të madhe të organizatave aktive në vend; (2) të dhënat e vetëraportuara nga OSHC-të. Vlerësimi i kapacitetit u bazua në informacionet e marra përmes një vëzhgimi online të përfaqësuesve të OSHC-ve dhe vetëdeklarimit të tyre për të gjitha çështjet. Në këto kushte, të dhënat e vetëraportuara kufizohen nga fakti që ato mund të jenë subjektive dhe nuk mund të verifikohen në mënyrë të pavarur.

# SHKURTIME

- BE** Bashkimi Evropian
- OSHC** Organizata të shoqërisë civile
- PSH** Partnerët Shqipëri
- TVSH** Tatimi mbi Vlerën e Shtuar


# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME RRETH OSHC-ve PJESËMARRËSE NË VLERËSIM

**115**


organizata të shoqërisë civile, u bënë pjesë e këtij vlerësimi duke plotësuar pyetësorin online. Shtrirja e tyre gjeografike është nga mbarë vendi duke përfshirë qytete si Berat, Dibër, Divjakë, Durrës, Elbasan, Fier, Fushë-Arrëz, Gjirokastër, Kamëz, Kukës, Kurbin, Lezhë, Librazhd, Përmet, Peshkopi, Pukë, Sarandë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë.

Pavarësisht kësaj shtrirje rreth **43% e OSHC-ve** të përgjigjura janë nga **Tirana**, aty ku dhe dendësia e shtrirjes së organizatave jofitimprurëse në vend është më e madhe.


## Forma e organizimit të OSHC-ve pjesëmarrëse




## Fushat e veprimtarisë së OSHC-ve\*



## Zona gjeografike e ushtrimit të aktivitetit të OSHC-ve\*



## Shpërndarja e OSHC-ve sipas vitit të themelimit




## Përfaqësimi gjinor i punonjësve të OSHC-ve




## Çështje me interes për rritje kapacitetesh organizative për OSHC\*


Nga të dhënat e vlerësimit rezulton se qendrueshmëria financiare vijon të mbetet çështja më me interes për OSHC-të për rritjen e kapaciteteve, e përzgjedhur në 75% të rasteve, pasuar nga qeverisja dhe manaxhimi organizativ me 50% të rasteve dhe kuadri ligjor dhe fiskal për OJF-të me 44% të rasteve të përzgjedhura nga OSHC-të.



Qendrueshmëria financiare




Qeverisja dhe manaxhimi organizativ



Kuadri ligjor dhe fiskal

## Çështje me interes për rritje kapacitetesh organizative sipas vjetërsisë së OSHC-ve\*


Kjo renditje e nevojave paraqitet të jetë e njëjtë, krahasuar edhe me nevojat e OSHC-ve sipas vjetërsisë së tyre, fushës së veprimtarisë apo vendndodhjes, qoftë kjo në kryeqytet apo jashtë tij.



## Çështje të kuadrit ligjor dhe fiskal me interes për rritje kapacitetesh\*


Të pyetur më specifikisht mbi çështje dhe tematika konkrete me interes për programe për rritje kapaciteti mbi kuadrin ligjor dhe atë fiskal, tema legjislacioni tatimor/ detyrimet fiskale dhe raportimi financiar rezulton me interesin më të madh për OSHC-të e përgjigjura.

Kjo renditje rezulton pothuajse e njëjtë edhe krahasuar me vendndodhjen gjeografike të OSHC-ve.



## Çështje të kuadrit ligjor dhe fiskal me interes për rritje kapacitetesh sipas vjetërsisë së OSHC-ve \*

Situata paraqitet paksa më ndryshe, nëse krahasojmë nevojat e OSHC-ve në këtë kuadër sipas vjetërsisë së tyre. Organizatat me më shumë vjetërsi rendisin si nevojë të parë për rritje kapacitetesh procedurat e rimbursimit të TVSH- së vijuar nga çështje mbi legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ndërsa OSHC-të e themeluara në 3 vjeçarin e fundit, rendisin si nevojë kryesore çështje të legjislacionit tatimor/ detyrime fiskale dhe raportimi financiar, pasuar nga regjistrimi/ përditësimi i të dhënave të pronarit përfitues.



## Çështje të manaxhimit organizativ me interes për rritje kapacitetesh\*

Hartimi i strategjive dhe planeve për ngritjen e fondeve, rezulton të jetë çështja me interes më të lartë për organizatat e shoqërisë civile. Nevoja për rritje kapacitetesh në këtë drejtim vijon të mbetet e lartë në këtë vlerësim, në linjë edhe me vlerësime të tjera të viteve të fundit për kapacitetet e OSHC-ve.




## Çështje të manaxhimit organizativ me interes për rritje kapacitetesh sipas vjetërsisë së OSHC-ve\*

Nëse krahasojmë nevojat për rritje kapacitetesh mbi çështjet e renditura bazuar në vjetërsinë e OSHC-ve të përgjigjura, renditja e nevojave në vështrim të parë nuk paraqet ndonjë ndryshim thelbësor.

Por, ajo çfarë vihet re në këtë analizë krahasimore është se për OSHC-të e themeluara përgjatë intervalit kohor **2006-2010**, hartimi i planeve strategjike dhe politikave dhe procedurave të manaxhimit financiar renditet si çështja më me interes për të rritur më tej kapacitetet e tyre, respektivisht për **75%** dhe **67% të rasteve të përzgjedhura**.


Nevoja për Strategji/Plan Komunikimi paraqitet **pothuajse e njëjtë** si për OSHC-të me eksperiencë ashtu dhe për ato të krijuari rishtazi.






## Çështje të qendrueshmërisë financiare të OJF-ve me më shumë interes për rritje kapacitetesh\*

Nga të dhënat e grumbulluara, **ngritja e fondeve dhe burimeve të financimit për OSHC-të dhe programet e financimit të BE-së** rezultojnë dy temat më me interes për rritje kapacitetesh në aspektin e qendrueshmërisë financiare të OSHC-ve qofshin këto OSHC nga kryeqyteti apo jashtë tij.



## Vlerësimi i formave të aktiviteteve si më produktive, në zhvillimin e kapaciteteve dhe njohurive

Të pyetur për format më produktive të aktiviteteve që zhvillojnë kapacitetet dhe rrisin njohuritë, në një shkallë nga 1 deri në 3 ku 1 është më i rëndësishëm dhe produktiv, **programet afatgjata të trajnimit/leksionit kombinuar me mentorim/asistencë** si dhe **mentorimi dhe asistenca** si formë më vete, rezultojnë të jenë vlerësuar si më produktivët, në 43% të rasteve, pasuar nga aktivitete të ndarjes së eksperiencave si forume, vizita shkëmbimi apo studimore, në 38% të rasteve të OSHC-ve të përgjigjura.




# PJESËMARRJA E OSHC-VE NË POLITIKËBËRJE

## Përfshirja e organizatave në fushata advokacie në dy vitet e fundit

75% e OSHC-ve të përgjigjura pohojnë se kanë qenë të përfshira në fushata advokacie, përgjatë dy viteve të fundit.

Përfshirja ka qenë kryesisht si pjesë e një grupimi organizatash por dhe nëpërmjet fushatave të organizuara nga vetë organizata.


Nga të dhënat e vlerësimit nuk vihet re diferenca në pjesëmarrjen e OSHC-ve në fushata advokimi bazuar në vendndodhjen e tyre.



## Përfshirja e organizatave në fushata advokacie në dy vitet e fundit sipas fushave të veprimtarisë\*

Nëse analizojmë përfshirjen e organizatave sipas llojit të veprimtarisë së tyre, nivelet më të larta të përfshirjes, pavarësisht formës, janë ato të OSHC-ve që punojnë kryesisht në fusha si: të drejtat e njeriut, të rinjtë dhe fëmijët, fuqizimi i gruas dhe çështjet gjinore, zhvillimi i shoqërisë civile dhe vullnetarizmit, demokracia, qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit si dhe mbrojtja sociale / shërbimet sociale.

Ndërkohë arsyet kryesore për mospërfshirje nga OSHC-të në fushata advokacie raportohet të jenë mungesa e kapaciteteve njerëzore për 52% të rasteve si dhe vështirësia në bërjen bashkë/rrjetëzimi me organizatat e tjera për 24% të rasteve të përzgjedhura, ndërsa për 14% të rasteve advokacia nuk është në fokus të punës së organizatës dhe 19% e tyre kanë listuar arsye të tjera për mospërfshirje, si psh. të qenit një organizatë e re apo mos paraqitja e një mundësie të tillë përgjatë kësaj periudhe.




## Nevoja për rritje kapacitetesh në advokim

Nga të dhënat e vlerësimit, **hartimi i planeve të advokimit**, rezulton si nevoja më e lartë për rritje kapacitetesh në **59% të rasteve të përgjigjura**, pasuar nga nevoja për rritje kapacitetesh në **zbatimin e fushatave në 45% të rasteve** dhe **monitorimin e fushatave të advokimit në 41% të rasteve**. 14% e OSHC-ve pohojnë se kanë të tjera nevoja në lidhje me këtë çështje si: nevoja për rritje kapacitetesh në komunikimin dhe qasjen me institucionet, nevoja për rritje kapacitetesh mbi advokimin specifikisht për anëtarët e rinj të stafit në organizatë etj.


Kjo renditje nuk rezulton të ndryshojë krahasuar me llojin apo fushën e veprimtarisë së organizatës.

### sipas fushës së veprimtarisë\*




## Çështje të zbatimit të fushatave të advokimit me më shumë interes për rritje kapacitetesh\*

### ➤ sipas vendndodhjes së OSHC-ve



### ➤ sipas vjetërsisë



Të pyetur më konkretisht mbi çështje specifike të zbatimit të fushatave të advokimit me më shumë interes për OSHC-të, hartimi dhe shkrimi i dokumentave të politikave (policy paper) rezulton nevoja më e lartë për rritje kapacitetesh.

Nga ana tjetër, kjo renditje nevojash ndryshon disi për organizatat që ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë kryeqytetit ku si nevojë më e madhe identifikohet çështja e mobilizimit të aktorëve mbështetës dhe komunitetit.


Nëse do t'i analizonim të dhënat mbi nevojat, në raport me vitin e themelimit të OSHC-ve, renditja e mësipërshme ndryshon. Kështu për organizatat me më shumë vjetërsi, nevoja për rritje kapacitetesh në çështje të lobimit me vendimmarrësit rezulton të jetë me interes më të lartë.

## Pjesëmarrja e OSHC-ve në Rrjete/ Koalicione

Nga të dhënat e vlerësimit **81%** e OSHC-ve të përgjigjura, pohojnë se janë pjesë e një rrjeti/koalicioni formal ose informal. Në 59% të rasteve OSHC-të e përgjigjura pohojnë se janë pjesë e një rrjeti/koalicioni në nivel kombëtar, në 33% të rasteve janë pjesë e një rrjeti/koalicioni në rajonin e Ballkanit Perëndimor, në 30% e rasteve janë pjesë e rrjeteve/koalicioneve në BE dhe më gjerë dhe në 24% të rasteve janë pjesë e rrjeteve/koalicioneve në nivel lokal.


## Nevojat e OSHC-ve për rritjen e efektivitetit të punës së rrjete/koalicione\*

Pavarësisht përfshirjes së pjesës më të madhe të OSHC-ve në rrjete/koalicione, identifikimi dhe gjetja e partnerëve të përshtatshëm për rrjetëzim, raportohet si nevoja më e madhme interes për rritjen e efektivitetit të punës së rrjeteve/koalicione në 62% të rasteve të përzgjedhura.



## sipas vjetërsisë së OSHC-ve\*

Nëse krahasojmë renditjen e këtyre nevojave, në raport me vjetërsinë e OSHC-ve, çështja e identifikimit dhe gjetjes së partnerëve të përshtatshëm për koalicione paraqitet si sfidë në të njëjtat nivele si për OSHC-të me vjetërsi më të madhe (1990-1995) ashtu dhe për ato të krijuara në tre vitet e fundit.




# Përfshirja e OSHC-ve në procese konsultimi mbi politika dhe projektligje gjatë vitit 2021-2022\*

Shumica e OSHC-ve pjesë e vlerësimit pohojnë se kanë qenë të përfshira në procese konsultimi mbi politika dhe projektligje përgjatë 2021-2022. Ndërkohë, **66%** e OSHC-ve që pohojnë se NUK kanë qenë pjesë e proceseve të tilla, janë të vendosura jashtë kryeqytetit, çka tregon për nevojën për përfshirje më të madhe të OSHC-ve nga mbarë vendi në procese konsultimi dhe politikë-bërje.


Si arsye kryesore të mospërfshirjes në procese konsultimi OSHC-të listojnë: mungesën e njoftimeve dhe informacionit mbi organizimin e proceseve me pjesëmarrje nga institucionet përgjegjëse; pamundësinë e stafit për të marrë pjesë për efekt kohe/angazhimesh të tjera dhe burimet njerëzore të limituara; mungesën e vëmendjes nga institucionet ndaj problematikave në fokus të veprimtarisë së organizatës apo moszbatimin e kuadrit ligjor ekzistues mbi këto problematika etj.

Megjithëse **40%** e OSHC-ve krijuar në tre vitet e fundit **raportojnë se janë përfshirë në procese të tilla**, nevoja për përfshirje dhe zhvillim kapacitetesh në këtë drejtim mbetet e lartë.



## sipas fushës së veprimtarisë


Përfshirja në procese konsultimi, është e shtrirë në të gjitha fushat e veprimtarisë që OSHC-të ushtrojnë por më së shumti, pjesëmarrja është më e lartë në fusha si të drejtat e njeriut, të rinjtë dhe fëmijët, zhvillimi i shoqërisë civile dhe vullnetarizmi dhe fusha e demokracisë, qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit.



## Nevojat për rritjen e kapaciteteve lidhur me pjesëmarrjen në proceset konsultuese dhe politikëbërëse\*

Njohja me mekanizmat dhe strukturat e bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile, rezulton si nevoja më e raportuar nga OSHC-të, për rritje kapacitetesh në lidhje me pjesëmarrjen në procese politikëbërëse, ndjekur nga nevoja për njohje me dokumenta strategjik dhe strukturat për bashkëpunim mes organizatave dhe qeverisë.

Ndërkohë nëse analizojmë të dhënat e grumbulluara në raport me vendndodhjen, njohja me format dhe teknikat e pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe politikëbërje, si dhe njohja me dokumentat strategjikë dhe strukturat për bashkëpunim mes organizatave dhe qeverisë rezultojnë si nevojat më të mëdha.




## Vlerësimi i nivelit të njohurive të OSHC-ve mbi procesin e integrimit të vendit në BE

Të pyetur mbi nivelin e njohurive të organizatës mbi procesin e integrimit të vendit në BE duke përfshirë këtu njohuri si procesi i negociatave, kapitujt, strukturat e tij dhe rolet, etj, **32% e OSHC-ve** pjesëmarrëse e kanë vlerësuar nivelin e njohurive si **“të mirë”**, **27% si “mesatar”**, **21% si “shumë të mirë”**, **17% si “të ulët”**, ndërkohë **3%** e tyre përgjigjen se **“nuk kanë njohuri”**.


Ky vlerësim paraqitet i njëjtë edhe krahasuar me nevojat e OSHC-ve në raport me vendndodhjen e tyre.

Ndërkohë, nëse analizojmë vlerësimin e njohurive në këtë drejtim në raport me vjetërsinë e OSHC-ve vëmë re se njohuritë tentojnë të vlerësohen më shumë drejt nivelit **“mesatar”**.




## Roli i shoqërisë civile në procesin e integrimit sipas OSHC-ve\*

Qendrimi i OSHC-ve kundrejt rolit të shoqërisë civile në procesin e integrimit evropian, nuk ka pësuar ndryshime në vitet e fundit nëse i referohemi raporteve të mëparshme. OSHC-të në pjesën më të madhe, shohin si rol kryesor të tyre në këtë proces, informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, pasuar nga dhënia e ekspertizës sipas fushave përkatëse.



## Informacioni i OSHC-ve për platformat dhe strukturat për integrimin, krijuar në nivel ndërinstitucional

Nga të dhënat e vlerësimit, rezulton se 42% e OSHC-ve të përgjigjura nuk kanë informacion mbi platformat dhe strukturat për integrimin krijuar në nivel ndërinstitucional. Kjo mungesë informacioni theksohet akoma më shumë tek OSHC-të që ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë kryeqytetit.




## Vlerësimi i kapaciteteve për t'u përfshirë në tryeza/grupe me përfaqësues të qeverisë dhe grupeve të interesit gjatë procesit të negociatave për integrimin në BE

Të pyetur se si i vlerësojnë kapacitetet e tyre për t'u përfshirë në tryeza/grupe punë me përfaqësues të qeverisë dhe grupeve të interesit gjatë procesit të negociatave për integrimin në BE, **44% e OSHC-ve** të përgjigjura vlerësojnë se kanë pak kapacitete dhe dëshirojnë t'i zhvillojnë ato më tej, ndërkohë që vetëm **9%** e tyre shprehen se kanë shumë kapacitete në këtë drejtim.



## Vlerësimi i kapaciteteve sipas vjetërsisë


Ky vlerësim kapacitetesh, paraqitet lehtësisht ndryshe për një pjesë të OSHC-ve të përgjigjura, krahasuar me vjetërsinë e tyre ku, për OSHC-të e themeluara përgjatë intervaleve kohore 2001-2005 dhe 2021 e në vazhdim, kapacitetet vlerësohen kryesisht si të mjaftueshme.






## Aksesi i OSHC-ve në media

Media lokale vijon të mbetet më e aksesueshme për OSHC-të krahasur me atë kombëtare. Kështu për 36% të OSHC-ve media lokale konsiderohet si e aksesueshme dhe për 32% si shumë e aksesueshme. Nga ana tjetër, aksesimi në median kombëtare ka pësuar rritje prej 12% krahasuar me gjetjet nga raporte të mëparshme vlerësimi.[1]




## 5 kanalet e komunikimit që përdoren më së shumti\*

Mediat Sociale vijojnë të mbeten ndër kanalet e komunikimit më të përdorura nga OSHC-të edhe përgjatë 2022, ku Facebook renditet si kanali më i përdorur me 94% të rasteve, pasuar nga Instagram i cili krahasuar me gjetjet e raporteve të viteve të shkuara, ka pësuar një ngritje[1] në renditje të mjetëve dhe kanaleve të komunikimit për OSHC-të.



## Nevojat e OSHC-ve për një bashkëpunimin më efektiv me median në përgjithësi dhe sipas vendndodhjes\*

Nevoja e zhvillimit të dokumentave strategjikë dhe planeve të komunikimit për zhvillimin e marrëdhënies dhe komunikimit me median e publikun, rezulton të jetë nevoja më e madhe, për 25% të OSHC-ve pjesëmarrëse në vlerësim, pasuar nga rritja e kapaciteteve për përdorimin e mjeteve të komunikimit online dhe medias sociale me 22% të përgjigjeve. Kjo renditje e nevojave të identifikuar, ndryshon disi nëse nevojat do të analizoheshin në raport me vendndodhjen e OSHC-ve, ku rritja e kapaciteteve për përdorimin e mjeteve të komunikimit online dhe medias sociale rezulton si më e lartë me 28% të përgjigjeve.




\*Pyetje me shumë alternativa zgjedhjeje

[1] Vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri

## Nevojat e OSHC-ve për një bashkëpunimin më efektiv me median sipas vjetërsisë

Ndryshimet në nevojat e identifikuara, vihen re dhe në raport me vjetërsinë e organizatave. Kështu, si nevojë kryesore për organizatat e themeluara përgjatë 1990-1995 renditet rritja e kapaciteteve dhe aftësive për të folur dhe prezantuar në publik me 44% të përgjigjeve, ndërkohë për OSHC-të e themeluara në tre vitet e fundit, nevoja kryesore në rritjen e kapaciteteve për një komunikim më efektiv me median rezulton krijimi i formateve të komunikimit me median si deklaratat për shtyp, njoftim për shtyp, etj.



- Tjetër
- Rritja e kapaciteteve dhe aftësive për të folurit dhe prezantimin në publik
- Krijimi i mundësive për vendosje kontaktesh me median/gazetarët
- Krijimi i formateve të komunikimit me median (deklaratë për shtyp, njoftim për shtyp, etj)
- Rritja e kapaciteteve për përdorimin e mjeteve të komunikimit online dhe medias sociale
- Zhvillimi i strategjisë / planit të komunikimit me median

# PËRFUNDIME

## Qeverisja organizative, zhvillimi dhe manaxhimi organizativ:

- Qendrueshmëria financiare vijon të mbetet çështja më me interes për OSHC-të për rritjen e kapaciteteve, pavarësisht fushës së tyre të veprimtarisë, vendndodhjes apo vjetërsisë. Programet e financimit të BE-së dhe ngritja e fondeve dhe burimeve të financimit për OSHC-të vlerësohen si dy temat me interes më të lartë për rritje kapacitetesh në kuadër të qendrueshmërisë financiare. Gjithashtu, gjetja e partnerëve për projekte të përbashkëta dhe shkrimi i projekt propozimeve identifikohen si tema me interes të lartë për mbi 50% të rasteve të OSHC-ve.
- Në lidhje me nevojat mbi kuadrin ligjor dhe fiskal për OJF-të, njohja dhe zbatimi i legjislacionit tatimor/ detyrimet fiskale dhe raportimi financiar, vlerësohet si nevoja më e madhe për rritje kapacitetesh për shumicën e OSHC-ve pjesëmarrëse në vlerësim. Nga ana tjetër, organizatat me më shumë vjetërsi identifikojnë si nevojë të parë për rritje kapacitetesh në këtë kuadër, njohuritë mbi procedurat e rimbursimit të TVSH si dhe çështje mbi legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
- Në aspektin e qeverisjes dhe manaxhimit organizativ, nevojat më të mëdha për rritjen e kapaciteteve të stafit të OSHC-ve rezultojnë të jenë në hartimin e strategjive dhe planeve për ngritjen e fondeve, si dhe në hartimin e planeve strategjike të OSHC-ve.

## Pjesëmarrja e OSHC-ve në politikëbërje:

- Përfshirja e OSHC-ve në advokim rezulton të jetë kryesisht si pjesë e iniciativave ndërmarrë nga një grupim organizatash ose si pjesë e iniciativave ndërmarrë nga vetë organizata. 75% e OSHC-ve pohojnë se kanë qenë të përfshira në fushata advokacie përgjatë dy viteve të fundit, por gjithsesi e konsiderojnë ende të nevojshme rritjen e kapaciteteve në këtë drejtim për fushata më efektive. Ndërkohë, nuk vihen re diferenca në përshirjen e OSHC-ve në fushata advokimi bazuar në vendndodhjen e tyre. Mungesa e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore raportohet si arsye kryesore e mospërfshirjes së OSHC-ve në fushata advokimi.
- Nevoja për rritje kapacitetesh për më shumë pjesëmarrje të OSHC-ve në politikëbërje, është e pranishme si në aspektin e hartimit të planeve të advokimit, (59% të rasteve) edhe në zbatimin dhe monitorimin e fushatave të advokimit (respektivisht në 45% dhe 41% të rasteve). Në përgjithësi, hartimi dhe shkrimi i dokumentave të politikave (policy paper) rezulton si çështja specifike me më shumë interes për OSHC-të për rritje kapacitetesh në zbatimin e fushatave të advokimit. Nga ana tjetër, analizuar me vendndodhjen dhe vjetërsinë e OSHC-ve kundrejt nevojave specifike, vihet re se për organizatat e vendosura jashtë kryeqytetit çështja e mobilizimit të aktorëve mbështetës dhe komunitetit paraqitet si nevoja kryesore, ndërkohë për organizatat me më shumë vjetërsi nevoja për rritje kapacitetesh në çështje të lobimit me vendimmarrësit rezulton të jetë me interes më të lartë (në 100% të rasteve të përzgjedhuara).

- OSHC-të rezultojnë të jenë pjesë e rrjeteve/koalicioneve më së shumti në nivel kombëtar, rajonal dhe Evropian. Përfshirja e OSHC-ve në rrjete me shtrirje veprimi lokal mbetet në nivele më të ulta. Identifikimi dhe gjetja e partnerëve të përshtatshëm për rrjetëzim vlerësohet si nevoja më e lartë, për rritjen e efektivitetit të punës së rrjeteve/koalicione (në 62% të rasteve të përzgjedhura).
- Pjesa më e madhe e OSHC-ve rezulton të jetë përfshirë në procese konsultimi përgjatë viteve 2021-2022, kjo pavarësisht vjetërsisë së tyre. Nga ana tjetër, 66% e OSHC që raportojnë se nuk janë përfshirë në procese të tilla, janë të vendosura jashtë kryeqytetit. Si arsye kryesore të mospërfshirjes në procese konsultimi OSHC-ë listojnë mungesën e njoftimeve dhe informacionit mbi organizimin e proceseve me pjesëmarrje nga institucionet përgjegjëse, pamundësinë e stafit për të marrë pjesë për efekt kohe/angazhimesh të tjera dhe burimet njerëzore të limituara, mungesën e vëmendjes nga institucionet ndaj problematikave në fokus të veprimtarisë së organizatës apo moszbatimin e kuadrit ligjor ekzistues mbi këto problematika.
- Njohja me mekanizmat dhe strukturat e bashkëpunimit qeveri-shoqëri civile, rezulton si nevoja më e madhe e OSHC-ve për rritje kapacitetesh në lidhje me pjesëmarrjen në procese politikëbërëse, ndjekur nga nevoja për njohje me dokumenta strategjik dhe strukturat për bashkëpunim mes organizatave dhe qeverisë.

### **Pjesëmarrja e OSHC-ve në procesin e integrimit Evropian:**

- Niveli i njohurive të OSHC-ve mbi procesin e integrimit të vendit në BE, vlerësohet të variojë nga mesatar deri në nivel shumë të mirë nga 80% e OSHC-ve.
- Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut vijon të konsiderohet si roli kryesor i OSHC-ve në procesin e integrimit evropian.
- 42% e OSHC-ve të përgjigjura rezultojnë se nuk kanë informacion mbi platformat dhe strukturat për integrimin, krijuar në nivel ndërinstytucional. Kjo mungesë theksohet akoma më shumë tek OSHC-të e vendosura jashtë kryeqytetit.
- Pavarësisht se shumica e OSHC-ve vlerësojnë se kanë kapacitete për t'u përfshirë në tryeza/grupe pune me përfaqësues të qeverisë dhe grupeve të interesit gjatë procesit të negociatave për integrimin në BE, 44% e tyre vlerësojnë se kanë pak kapacitete dhe dëshirojnë t'i zhvillojnë ato më tej.

### **Bashkëpunimi OSHC - Media:**

- Media lokale vijon të mbetet më e aksesueshme për OSHC-të krahasur me atë kombëtare.
- Kanalet e komunikimit më të përdorura nga organizatat për të informuar dhe ndërvepruar me publikun e gjerë janë: media sociale (kryesisht Facebook), Website-i i OSHC-së dhe media audiovizive lokale.
- Zhvillimi i dokumentave strategjikë dhe planeve të komunikimit për zhvillimin e marrëdhënies dhe komunikimit me median e publikun, si dhe rritja e kapaciteteve për përdorimin e mjeteve të komunikimit online dhe medias sociale, janë dy nevojat kryesore të OSHC-ve për një bashkëpunim më efektiv me median.

